

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Referendumi popullor – “çelësi i arte” per rrogat e gjykatësve dhe proukurorëve
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/referendumi-popullor-celesi-i-arte-per-rrogat-e-gjykatesve-dhe-prouku-i587724
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:45:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 15:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b65311a1b6796b3b9e4e9763278a0693280c3ee3d1599753e949ce51628fe794
TEKSTI	39543fc83da61bc4daabd5703e2eb64e8ac88a3444e0a92371396c2ee5da972b
PAMJA	30d8e9fe4983f7f4bd8892c51ecbff9fd069e11cef045458dbe6b74d7b158373

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c5742c5718ce66781971915d5f04a9c3db144420501ae89b34e1aaf3985564c6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c5742c5718ce66781971915d5f04a9c3db144420501ae89b34e1aaf3985564c6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by  [Kontakt](#)

 [English](#)

 [Zelensky tlet ne OKB: Moska ka pesuar humbje poshteruese! Vetem nje njeri deshiron lufte ne Ukraine](#) C'mimet e banesave t'renojne rritjen, por nuk u len duhen me shum
fundit

Referendumi popullor – “çelësi i arte” per rrogat e gjykatësve dhe proukurorëve

TemA

22 Shtator 2026, 17:15Blog TEMA



Muz ne i duket fundi luftes se gjykatësve e proukurorëve per çelien e rrogave te tyre, edhe pse ministrit te ligjit padjetas nga Kuvendi i Shqipërisë. Ata e quaj

nen për rindërtimin e gjykatësve e prokurorëve për rrogat e tyre, edhe pas miratimit të ligjit për pagesë nga shteti për kompensatë. Ata e çështjen prape në Gjykatën Kushtetuese, sikur kjo të mos kishte punë tjetër, por të merrej vetëm me rrogat e tyre për muaj me radhë.

Deri tani ata, gjyqtarët dhe prokurorët, bashkë me shoqatat e tyre, i kanë zgjidhur të gjitha çështjet e tjera të drejtësisë shqiptare; e kanë ndare me “peshoren e drejtësisë” të drejtën nga e shtrembra; i kanë zgjidhur me “konsensus” të plote konfliktet e tyre me avokatët për çështjet e transparenës së gjyqeve; e kanë kenaqur pra popullin e tyre me drejtësi të pafund. Nuk gjen dot asnjë njeri sot në Shqipëri që të thotë një gjysmë llafi të keq për gjykatësit e prokurorët, qoftë larg!

Tani u ka mbetur pa u zgjidhur (ashtu siç e duan ata) vetëm problemi i rrogave të tyre të vogla shumëmilioneshe. Për këtë arsye kanë vendosur t’u hapin lufte frontale edhe njëherë tjetër në Gjykatën Kushtetuese njëherazi Parlamentit, qeverisë dhe Presidentit të Republikës, të bindur se e drejta e kulluar është vetëm me ta. Nderkohe, 500 mijë pensionistë shqiptarë e kanë pensionin me pak se 200 Euro në muaj.

Në keto rrethana aspak premtuese për daljen me “paqe” nga ky konflikt absurd, kur nuk pin me uje as dialogu i kërkuar nga qeveria, mbeten vetëm dy zgjidhje të situatës me “duar të pastra” për problemin. E para: Gjykata Kushtetuese t’u thotë atyre, gjykatësve dhe prokurorëve pra: Une nuk merrem me me këtë punë. Çfarë kisha për të thënë e thashe para 7 muajsh. Me kaq mbyllet puna ime me rrogat. Nuk jam unë shefi i llogarise i ndermarrje që quhet Shqipëri. Jam Gjykata Kushtetuese. Une nuk mund të dal mbi parlamentin i cili është autoriteti i vetëm që miraton “kuletën” e parave në Shqipëri në atë që quhet Buxheti i Shtetit. Dhe parlamenti foli qartë me 84 vota për këtë problem.

Për me shume, t’u thotë Gjykata gjykatësve dhe prokurorëve, lexo Kushtetutën. Neni 2, fraksion 1: “Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i takon popullit. (jo Gjykatës Kushtetuese. H.J) Neni 2, fraksion 2: Populli e ushtron sovranitetin nepermjet perfaqesuesve të tij (kupto: deputeteve) ose drejtpërsdrejti (kupto me referendum)

Keshtu Gjykata Kushtetuese do të vriste tre zogj me një gur. E para, do të ruante nderin dhe autoritetin e vet, nga rreziku i kthimit e saj në një institucion bakallesh. E dyta do t’i shpetonte këtij populli nga 20 miliona Euro që do të harxhoheshin për një referendum në thelb të panevojshëm. E treta, do ta linte popullin e vet me një dhimbje koke me pak prej “tam – tameve” referendare gati dy –mujore. Kjo do ta nxirrte Gjykatën Kushtetuese me faqe të bardha nga ky siklet i “sokakut të marreve” (toponim nga Gjyrokastri ky) ku po kërkojnë ta fusin.

Rruga e dytë: organizimi (i detyruar) i referendumit kombëtar për rrogat me pyetjen e thjeshtë: A jeni dakord ju, të dashur atdhetarë, që rroga me e lartë në Republikën e Shqipërisë të jete ajo e Presidentit të Republikës dhe jo ajo e gjykatësve dhe prokurorëve? Ose di çka tjetër e tillë. Mazhoranca i ka në dorë të gjitha “veglat” për të bërë këtë brenda tridhjetë ditëve: Edhe Kuvendin, edhe qeverinë, edhe Presidentin. Çfarë duhet tjetër? Në vitin 1994 Berisha e organizoi referendumin kombëtar brenda 26 ditësh. Referendumi do të ishte “ çeles i arte” që do t’i vinte kapak floriri për një tridhjetë vjetet e ardhshme shërrit për rrogat e gjykatësve dhe prokurorëve. E thotë Kushtetuta (Lexo me lart)

Shqipëria ka përvorje në fushën e referendumeve. Janë tre të tilla në shkallë vendi deri tani, përkatësisht në vitin 1994 për kushtetutën, në vitin 1997 për formën e regjimit dhe në 1998 për kushtetutën. Në rastin e tanishëm gjyqtarët dhe prokurorët do të kishin mundësinë fatlume të dilnin në fushatë e t’i benin thirrje popullit që të votonte për rrogat e tyre, të gjykatësve dhe prokurorëve pra në referendum. Dhe populli do të shkonte të votonte me dashuri të madhe për ta, ashtu siç votonte për gjyqtarët edhe në kohën e Enverit, që në orën gjashtë të mëngjesit, pa u zbardhur mirë dita. Veçanërisht ata 500 mijë pensionistët që e kanë pensionin me pak se 200 Euro në muaj.

Në referendumin e vitit 1994 gati 100 mijë vota dolën të pavlefshme, sepse votuesit kishin shprehur “dashurinë” e tyre të pakufishme për pushtetin, duke shpalosur në fletët e votimit të gjithë fjalorin pezhorativ të gjuhës së pasur shqipe, që nga koha e origjinës indo – evropianiste të saj, për shefin e referendumit, Berishën dhe qeverinë e tij të kohës. Është mirë të nxirren mesime nga historia jonë e re demokratike në fushën e referendumeve. Sipas sondazheve sotme të mediave, mbi 70 përqind e shqiptarëve nuk e miratojnë marrezinë e rrogave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kur rroga e kryetarit të Gjykatës së lartë shkon të 9000 euro në muaj e kërkon edhe më tej.

Në këtë rast të referendumit edhe Gjykata Kushtetuese nuk do të shpetonte dot pa “u lagur” me veprimet e saj, pas rezultatit të qartë që tani të tij, ende pa u zhvilluar.

9 Komente



Kiri

22 Shtator 2026, 17:42

Shume e drejte te pyetet POPULLI per rrogat e kesaj celule terroriste te Sali serbit qe vetem drejtesi nuk jep

👤 **Përgjigjuni**

👍 7 🗳️ 0 ❤️ 1



Suflaqe

22 Shtator 2026, 18:22

Jo mo Jo kjo teza që i ka saliu Ju duhet hajdutëve, pse deputetë që 80% janë memece nuk flasin nuk prezantojnë asnjë projekt-ligj marrin 4-5 mijë euro rroga? Nëpunësit shtetëror nga ministrat 8-10 mijë euro sidomos policia duhet ta kenë me ligj minimum 2.500€ se nuk luftohet korrupsioni me 800€ rrogë Referendum bëhet për çështje kombëtare si Zvërneci, Sazani etj jo për rrogat e gjyqtarëve që janë shtylla e mbrojtjes së kushtetutës

👤 **Përgjigjuni**

👍 0 🗳️ 4 ❤️ 1



Dire Straits !!!

22 Shtator 2026, 19:00

Cfare flet ky more.....ky vend ka patur nje mije halle te tjera qe ndikonin direkt te populli ...dhe nuk u lejua te beheshin referendume....tani duhet te bejme referendum per rrogat e gjykatesve.....

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Duhet bëre referendum popull!

22 Shtator 2026, 17:45

Te lumtë! Unë jetoj në USA dhe po bëj një paralelizem me shkrimin tënd. Ditën e votimit ne Amerike, fleta e votimit ne kryje pika 1ka zgjedhjen e presidentit. Pika 2 ka zgjedhjen e senatit. Pika 3 zgjidhen kongresmenët. Pika 4 kryetari i gjykates. Pika 5 kryeprokurori. Ketu mbaron zgjedhja federale. Me poshte vijojnë zgjedhjet e shteteve. Me poshte te qytetit ku jeton perfshihen gjith problematikat madhore deri në prerja e një peme. Kjo behet per mos kete kosto te lartë votimi ne çdo shkllë duke i permblodhur në një flete votimi. Ne rastin konkret le te arxhohen ato 20 miljon euro per kete problem ama bihem reat si popull!.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 5 🗳️ 0 ❤️ 0



Arbi

22 Shtator 2026, 18:19

Duket që nuk ke haber fare, po fare, nga ky lëmë...

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Ard

22 Shtator 2026, 18:20

Shto ne referendum edhe rrogat dhe privilegjet e deputeteve.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 1 ❤️ 1



keqardhje

22 Shtator 2026, 18:46

Sot, ne kushtet kur shume shqipefoles ne bulevard apo pallatet e drejtesise, ne mazhorne apo opozit, e vetmja rruge demokratike per zgjidhjen e problemeve shqiptare eshte REFERENDUMI POPULLOR, fjala e fundit dhe me e larta ne demokraci. Prandaj, Edi Rama dhe mazhoranca te shpalle referendumin per nje sere çeshtje duke mbyllur plaget qe po shkatellojne huliganet. Nuk mund ta mabjne bran Shqiperine kriminelat, hajduyay dhe tradhetaret, manipuluesit dhe ata qe furnizohen nga jashte me para e dogma.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 2 🗳️ 0 ❤️ 0



toni mavrija

22 Shtator 2026, 19:00

Le te behet referendum dhe te percaktohet raport i rrogave(pensioneve) per te gjithë administraten deri te deputetet e presidenti.Ato qe jane vendosur deri tani jane abuzime te pajustificueshme me gjakun e popullit, jane veprime shushunjash.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 0



Toni

23 Shtator 2026, 17:50

Ata , dmth gjykatesit dhe prokuroret nuk i kerkojne se keshtu ju ngrit ne nje mengjes te bukur ...por kane para qe derdhet paraja e zeze , shperdoret gjithndej , rembejne qeveritaret e akuzuar per shperdorim dhe mosedim dhe thone : perse mos te perfitojme dhe ne nga okazoni , ci qi temen se

kur dhe kush do i paguaj ato fonde , ne te jemi mire dhe te kenaqur ...se nese mendoni se ato para dalin nga buxheti gaboheniqeveritaret tane marin borxhe neper banka te ndryshme dhe cu japin partneret tane europiane ...keto kerkojne pirankat e drejtesise ...per mendimin tim krejt personal , qeveria ose parlamenti nuk duhet te beje pas dhe te jap OK , pasi dihet boterisht qe drejtesia eshte vetem fillimi me pas orteku i kerkesave do filloj e sdo mabroj ...keshtu qe nje JO te madhe , nuk jane keq , dhe ne propocion me cjamin te marin , e nuk jane ne nivelin e kerkuar , sa qe Berisha vodhen sa deshin tani kerkojne me tepershifni pensionet se ne cnivel jane pastaj kerkoni ...nuk mund te kete 500 mije pensione ne 200 Euro dhe ata kerkojne 10 fishin

👤 [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0

💬 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Nxitimi i SPAK ndaj kreut të SHISH, përballë brishtësisë së një institucioni delikat

17:00 Blog / 10 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.